



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:103799

Datë: 18.11.2020

Numri i dokumentit: 01279751

C.nr.1024/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, sipas gjyqtares Merita Baloku, në çështjen juridiko- kontestimore, duke vepruar sipas padisë së paditësit I. (S.) K., nga fsh. Komuna e Pejës, kundër të paditurit: K.(A.)K.nga fshati Komuna e Pejës, të cilin e përfaqëson Arben Kelmendi av. në Pejë, për vërtetimin e pronësisë vlera e kontestit 1000 €, në seancën e shqyrtimit kryesor, në prezencë e paditësit të paditurit dhe të autorizuarit të tij, me datë 17.11.2020, murr këtë:

A K T G J Y K I M
Në bazë të pohimit

- I. APROVOHET**, kërkesëpadisë I. (S.) K., nga fshati Komuna e Pejës në tërësi si e bazuar, dhe
- II. VËRTETOHET**, se paditësi I. (S.) K. nga fshati, Komuna e Pejës, është pronar në bazë të mbajtjes me mirëbesim dhe punës së vlefshme juridike i ngastrës kadastrale nr. P-....., në sipërfaqe prej 12408 m² ZK, Komuna e Pejës.
- III. DETYROHET**, i padituri K. (A.) K.nga fshati Komuna e Pejës, që paditësit t' ia pranojë këtë të drejtë dhe të lejojë që kjo e drejtë të regjistrohet në emër të paditësit I. (S.) K., në Regjistrin e Drejtave të Patundshmerive, pranë Zyrës Kadastrale në Pejë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

A r s y e t i m

Paditësi, I. Kelmendi nga fsh. Komuna e Pejës, në këtë gjykatë, me dt. 27.08.2020, ka parashtruar padi për vërtetim pronësie, kundër të paditurit K. (A.) K.nga fshati Komuna e Pejës.

Me padinë e parashtruar paditësi I. ka theksuar se: në vitin 1980, parcelën me numër P-....., në sipërfaqe prej 12408 m² ZK, Komuna e Pejës, e ka blerë për çmim të shitblerjes 12.500 DM. Me rastin e shitblerjes, është përpiluar edhe kontratë, çmimi shitblerjes në tërësi është paguar dhe nga shitësi, këtu i padituri patundshmeria i është dorëzuar paditësit. Kjo ngaster formalisht evidentohet në emer të paditurit, i propozon gjykates qe ta caktoi shqyrtimin kryesor dhe pas administrimit të provave të aprovoi kërkespadinë e paditësit.

Në shqyrtimin kryesor të datës të dt.17.11.2020, paditësi I., ka deklaruar se: „unë këtë tokë e kam blerë para më shumë se 40 vite, nuk më kujtohet saktësisht se a e kam blerë, 13

mijë a 14 mijë marka. Vetëm unë e kam blerë këtë tokë dhe e shfrytëzoj që 40 vite. Këtë pasuri e kam blerë nga i padituri i cili është prezent këtu K.. Dhe kjo tokë ka një hektar e 24 ari e 80 metra, dhe është e rrethuar me gardh ashtu siç e kam blerë në ato mexha dhe nuk kam pasur problem asnjëherë në shfrytëzimin e saj. Përndryshe mbetem pranë padisë dhe kërkesës së saj, propozon që të administrohen provat sipas nevoje dhe gjykata ta aprovojë kërkesëpadinë”.

I autorizuari i paditurit K. në shqyrtimin kryesor të datës 17.11.2020 ka deklaruar se,, e pranojmë kërkesëpadinë në tërësi, këtë e deklaroj në bazë të autorizimit të noterizuar dhe nuk ka asgjë kontestuese, propozoj gjykatës që të aprovojë në tërësi kërkesëpadinë dhe sipas dispozitave ligjore të nxjerrë aktgjykim në bazë të pohimit. Është e vërtetë që shitblerja ka ndodhur këtë mund ta pohojë edhe i padituri i cili është prezent në këtë seancë”.

I padituri K. në shqyrtimin kryesor të datës 17.11.2020, deklaron: „janë të vërteta deklaratimet e palës paditëse, është e vërtetë që ia kam shitur këtë tokë dhe atë para 40 vitesh, mi ka paguar të hollat dhe qysh para 40 vitesh e shfrytëzon vetëm paditësi këtë tokë sepse unë e di që vetëm ky e ka ble dhe vetëm ky e shfrytëzon”.

Gjykata duke vlerësuar dhe duke pasur parasysh faktin se, i padituri e ka pohuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit dhe meqenëse palët mund të disponojnë lirshëm me kërkesat e tyre, konform nenit 3.1.2 të LPK-së, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm, e në kuptim të nenit 148.1 të LPK-së, ku thuhet se: ” në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep pa shqyrtim të mëtejshëm aktgjykimin më të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë“.

Bazuar në këtë gjykata konform nenit 148.1 lidhur me nenin 3.1 dhe 3.2 të LKP-së, ka vendosur si në diapszitiv të këtij Aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata ka vendosur duke u bazuar në nenin 463.1 të LPK-së, meqenëse asnjëra nga palët nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË C.nr. 1024/20 më datë 17.11.2020

G j y q t a r j a
Merita Baloku

KËSHILLA JURIDIKE:

Me që palët në procedurë kanë hequr dorë nga e drejta e ankesës Aktgjykimi është I plotfuqishëm me datë 17.11.2020